

## **KOMUNIKATË PËR MEDIA**

**16 korrik 2007**

### **Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shtyn afatin e fundit të parakualifikimit dhe ditën e ofertimit për katër Ndërmarrje të Reja të valës 26**

**PRISHTINË** –Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) njofton se katër Ndërmarrjet e Reja në vijim: “**Dubrava**”, “**Drelaj**”, “**NBI Suhareka Prona e Fermës së dhive** ” dhe “**Agrokultura Fabrika për Përpunimin e Mishit**”, janë tërhequr nga Vala 26-të e Privatizimit.

Këto katër Ndërmarrje të Reja tani janë përfshirë në valën e 27-të të Privatizimit dhe dita e fundit për parakualifikim për këto Ndërmarrje të Reja do të jetë me 15 gusht 2007, ndërsa dita për dorëzim të ofertave do të jetë me 22 gusht 2007.

Për më shume informata Kontaktoni Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM).

#### **Të dhëna për këto ndërmarrje:**

**Ndërmarrja e Re Dubrava Sh.P.K.** - me rreth 400 ha tokë bujqësore (me ferma me hangar dhe ndërtesa). Shtrihet në zonat kadastrale Dubravë, Shushice. Toka bujqësore është ngjitas për fermën me hangar dhe ka sistem të ujitjes. (Depoziti i Ofertës - 20.000€)

**Ndërmarrja e Re Drelaj Sh.P.K.** - subsidiarja shërben si pikë mbledhëse e frutave malore të ndryshëm e sidomos për boronica, gjithashtu dhe produkteve qumështore si djathit dhe mazës. E vendosur në një lokacion atraktiv të Grykës së Rugovës.

Ndërmarrja e Re përfshin objektin e ri të ndërtuar nga tullat dhe betoni me përafërsisht 345 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës është përafërsisht 42 ari e ndarë në tri parcela. Duhet të kini parasysh se nuk ka asete lëvizëse. (Depoziti i Ofertës - 20.000€)

**Ndërmarrja e Re NBI Suhareka Prona e Fermës së dhive Sh.P.K.** - përfshin një sipërfaqe të përafërt rreth 50 Ha (livadhe dhe tokë të punueshme) e cila gjendet në afërsi të fshatrave Sallagrazhdë dhe Grejkoc si dhe një numër të ndërtesave (montazh) me një sipërfaqe totale prej afërsisht 5,000 m<sup>2</sup>. (Depoziti i Ofertës - 20.000€)

**Ndërmarrja e Re Agrokultura Fabrika për Përpunimin e Mishit Sh.P.K.** - i jep mundësi investitorit të marrë fabrikën për përpunimin e mishit të vendosur në fshatin Velekincë (komuna e Gjilanit). Me blerjen e kësaj Ndërmarrje të Re do t'i hapet qasja në tregun Kosovar të ushqimit dhe do t'i lejohet mundësia e zgjerimit.

Prona që është lëndë e këtij tenderi ka një sipërfaqe toke prej përafërsisht 58,180m<sup>2</sup> (05.81.80 ha). Ndërtesat kryesore përfshijnë përafërsisht sipërfaqen prej 10,027 m<sup>2</sup> dhe hapësirën e hapur - oborrin sipërfaqe të përafërt prej 48,153 m<sup>2</sup> në kuadër të kompleksit të fabrikës për përpunimin e mishit. (Depoziti i Ofertës - 20.000€)